



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**RAPORT**

**MONITORIMI I MEDIAVE**

**GJATË FUSHATËS SË**

**ZGJEDHJEVE LOKALE 2017**

**RAUNDI I**

*21 shtator – 22 tetor 2017*  
*Prishtinë*



## **Përmbajtja**

<b>I. AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT .....</b>	<b>4</b>
<b>II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>5</b>
<b>III. BAZA LIGJORE .....</b>	<b>6</b>
<b>IV. METODOLOGJIA DHE REALIZIMI.....</b>	<b>6</b>
<b>V. GJETJET NGA MONITORIMI .....</b>	<b>8</b>
<b>SHKELJET E IDENTIFIKUARA DHE VEPRIMET E KPM-SË.....</b>	<b>9</b>
<i>Spotet politike më të gjata se dy minuta (120 s) - shkelje e nenit 49.1 të Ligjit për Zgjedhje .....</i>	<i>9</i>
<i>Spotet politike të pidentifikuara - shkelje e nenit 49.6 të Ligjit për Zgjedhje.....</i>	<i>10</i>
<i>Dështimi për të ofruar qasje të drejtë dhe të paanshme – shkelje e nenit 48 të Ligjit për Zgjedhje .....</i>	<i>10</i>
<i>Shkelje të Kodit të Etikës për Shërbimet Mediale Audio-vizuele .....</i>	<i>10</i>
<i>Prezenca e fëmijëve në spotet politike – shkelje e nenit 9.7 të Kodit të Etikës.....</i>	<i>11</i>
<i>Periudha e heshtjes zgjedhore .....</i>	<i>11</i>
<i>Mos ofrimi i Ditarëve – shkelje e nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje .....</i>	<i>12</i>
<i>Përfshirja e udhëheqësve të OSHMA-ve në zgjedhje .....</i>	<i>12</i>
<b>VI. ANKESAT E PARASHTRUARA .....</b>	<b>13</b>
<b>VII. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-të .....</b>	<b>14</b>
<i>Televizionet me transmetim tokësor me mbulim nacional.....</i>	<i>14</i>
<i>Televizionet me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Prizrenit .....</i>	<i>18</i>
<i>Televizionet me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Mitrovicës .....</i>	<i>20</i>
<i>Televizionet me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Gjilanit.....</i>	<i>21</i>
<i>Televizionet me transmetim tokësor me mbulim regjional e lokal në regjionin e Pejës.....</i>	<i>23</i>
<i>Televizionet me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes .....</i>	<i>24</i>
<b>VIII. SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË GJATË MONITORIMIT TË PAJTUESHMËRISË SË TË LICENCUARVE TË KPM-SË.....</b>	<b>28</b>
<b>IX. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>29</b>

## **I. AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT**

- **KPM-** Komisioni i Pavarur i Mediave
- **KQZ-** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- **PZAP-** Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
- **DMA-** Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së
- **SCP-** Subjekt i Çertifikuar Politik
- **OSHMA-** Ofrues i Shërbimit Medial Audio-Vizuale
- **MF-** Ministria e Financave
- **TV-** Televizion
- **RTV-** Radio dhe Televizion
- **Ditari-** Regjistër i evidencave të hapësirave që OSHMA ka ofruar për SÇP-të

## II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), duke qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i cili vlen edhe për zgjedhjet lokale, ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA) të cilat kanë mbuluar fushatën për Zgjedhjet Lokale 2017 në Republikën e Kosovës.

Qëllim i monitorimit të bërë nga periudha nga 21 shtator e deri më 22 tetor 2017, ishte vlerësimi i performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII të këtij Ligji, të titulluar “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Ky raport është realizuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) dhe prezanton të gjeturat nga monitorimi i performancës së OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore 30 ditore dhe ditës së heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.

Në monitorim janë përfshirë 25 ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, prej të cilëve nëntëmbëdhjetë (19) janë OSHMA që u takojnë kategorive me mbulim nacional, regjional dhe lokal në transmetim tokësor dhe gjashtë (6) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes.

Gjatë procesit të monitorimit, në fokus ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, spotet politike, kronikat zgjedhore, intervistat e debatet të transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Zyrtarë të Departamentit të Monitorimit dhe Analizës (DMA) kanë vlerësuar gjatë periudhës monitoruese: paanshmërinë në raportim, hapësirën e ofruar për SCP-të, gjuhën e përdorur dhe në përgjithësi pajtueshmërinë me Udhëzuesin për Zgjedhjet dhe aktet tjera nënligjore respektive të KPM-së.

Nga të gjeturat e monitorimit rezulton se përkundër disa përjashtimeve, prezantimi i fushatës për zgjedhjet lokale nga OSHMA-të ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtim me dispozitat për media në Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuele.

Në fillim të fushatës zgjedhore, DMA ka verifikuar nëse në Listat e KQZ-së për kandidatë për kryetarë të kuvendeve komunale dhe asamble janë përfshier pronarët ose drejtorët e OSHMA-ve. Kjo, me qëllim të shmangies së ndikimit apo animit të medias.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka certifikuar për këto zgjedhje 91 subjekte të certifikuara politike, prej tyre 1 koalicion, 35 parti politike, 30 iniciativa qytetare dhe 25 kandidatë të pavarur për kryetarë të komunave apo asambleist të kuvendeve komunale.

### **III. BAZA LIGJORE**

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Zgjedhjet nga të licencuarit. Kreu VIII i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin, i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet, i cili përbëhet prej:

1. KAPITULLIT I – identifikimi i reklamimit politik;
2. KAPITULLIT II – raportimi për hulumtimin e opinionit publik lidhur me zgjedhjet; dhe
3. KAPITULLIT III – periudha e heshtjes zgjedhore.

Sipas nenit 53 të këtij Ligji, KPM siguron që të licencuarit mirëmbajnë ditarë për të regjistruar kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera në medie, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilin Subjekt të Certifikuar Politik.

Për këtë qëllim, KPM ka dërguar te të licencuarit edhe format e ditarëve me dhe pa pagesë si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre.

### **IV. METODOLOGJIA DHE REALIZIMI**

Metodologjia e përdorur gjatë monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele në periudhën e Zgjedhjeve Lokale 2017, është bazuar në analiza sasiore dhe cilësore, me theks të veçantë në edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, spotet politike si dhe intervista e debate në përmbajtjet programore të OSHMA-ve të transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Metodologjia e monitorimit ka konsistuar në regjistrimin e programeve, kategorizimin e tyre, matjen e kohës/hapësirës së dedikuar secilit Subjekt të Certifikuar Politik (SCP) prej orës 16:00-24:00. Gjithashtu është bërë edhe dizajnimi i tabelave për futjen e të dhënave, vlerësimin e prezantimit të fushatës si: pozitiv, negativ apo neutral, përpunimin dhe analizën e të dhënave të fituara dhe në fund hartimin e raportit final lidhur me mbulimin medial të fushatës zgjedhore. Nxjerrjen e këtyre të dhënave e mundësoi sistemi i monitorimit të cilin e posedon KPM, përmes të cilit bëhet pranimi, incizimi dhe arkivimi i programeve të transmetuara të OSHMA-ve varësisht nga nevojat e KPM-së.

Matja e hapësirës së dedikuar SCP-ve është bërë duke llogaritur kohën në sekonda (në lajme, intervista, debate dhe kronika zgjedhore). Bazuar në këto llogaritje, janë dhënë tabelat për kohën e ofruar për SCP-të në sekonda dhe përqindje.

Analizat janë bërë për të vlerësuar nëse:

- OSHMA-të kanë raportuar në mënyrë të drejtë dhe korrekte lidhur me aktivitetet dhe fushatën e subjekteve të certifikuar politike në kuptimin e raportimit objektiv dhe të paanshëm;
- OSHMA-të kanë ofruar mundësi për promovimin e platformave politike të SCP-ve në garë (hapësira e vënë në dispozicion për SCP-të në emisione informative, debate, intervista gjatë shpalesjes së programeve nga përfaqësuesit e SCP-ve);
- OSHMA-të kanë ofruar qasje të njëjtë për SCP-të në debate/intervista, pyetje të njëjta, mundësi për replikë në emisione debatuese, renditje të aktiviteteve zgjedhore në lajme e kronika zgjedhore (renditja me rotacion duke mos favorizuar prezantimin e aktiviteteve të SCP-ve me renditje të njëjtë për çdo ditë të fushatës);
- OSHMA-të kanë vepruar në pajtueshmëri me heshtjen zgjedhore dhe dispozitat tjera të Ligjit për Zgjedhje, gjatë transmetimit të informatave rreth procesit dhe mbarëvajtjes së votimit si dhe deklaratat, intervistat e konferencat për media të SCP-ve.

Gjatë analizës është bërë edhe vlerësimi për mënyrën e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në pajtim me Kodin e Etikës dhe standardet profesionale të gazetarisë (nëse ka pasur nxitje të urrejtjes, gjuhë të papërshtatshme, denigruese, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna në Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës).

Të gjeturat në këtë raport janë të periudhës së monitorimit nga data 21 shtator deri më 22 tetor 2017, gjatë së cilës KPM ka monitoruar performancën e 25 ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA).

Në monitorimin e fushatës për zgjedhjet lokale janë përfshirë:

- OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim nacional (*RTK1, TV21 dhe KTV*);
- OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim lokal/regjional (*TV OPINION, TV BESA, TV PRIZRENI, TV BALLKAN, TV MOST, TV MITROVICA, TV MIR, TV LIRIA, TV ILIRIA, TV TEMA, TV VALI, TV PULS, TV HERC, TV FESTINA, TV DUKAGJINI, TV SYRI VIZION*), dhe
- OSHMA-të me program gjeneralistik të cilët operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (*RTK2, RROKUM TV, TV KIM, TRIBUNA CHANNEL, KLAN KOSOVA dhe TV KISS*).

Fushatën zgjedhore nuk e kanë mbuluar: TV BALLKAN, TV HERC dhe TV FESTINA. Për shkak të problemeve teknike me arkivim të sinjalit në raport nuk është përfshirë TV ZOOM, i cili edhe pas kërkesës së KPM-së nuk e ka sjellur arkivën e programit të transmetuar, duke e pamundësuar monitorimin e prezantimit të fushatës zgjedhore nga kjo OSHMA. Poashtu për shkak të problemeve teknike, DMA nuk ka mund të sigurojë të dhëna të sakta për mbulimin e fushatës nga OSHMA TV KISS.

## V. GJETJET NGA MONITORIMI

Bazuar në monitorimin e performancës së OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës, KPM ka gjetur se mbulimi i garës për Zgjedhjet Lokale 2017, ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht Kreun VIII- të këtij Ligji të titulluar “Mediat gjatë Fushatës Zgjedhore”.

Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-vizuele (OSHMA) gjatë kësaj periudhe kanë prezantuar fushatat e subjekteve të certifikuara politike, pjesëmarrëse në këtë garë. Përveç termineve të ofruara me pagesë dhe pa pagesë, ku kandidatët e SCP-ve kanë shpalosur programet e tyre, janë transmetuar edhe pika reklamuese politike të cilat me përjashtim të disa rasteve, janë identifikuar siç duhet dhe nuk kanë tejkaluar kohëzgjatjen prej 2 minutash të paraparë me Ligjin për Zgjedhje.

Përveç prezantimit të aktiviteteve të SCP-ve në lajme, kronika zgjedhore e spote politike, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele kanë transmetuar edhe intervista e debate. Karakteristikë për shumicën e debateve të transmetuara ishin pyetjet e njëjta dhe hapësira e përafërt për të gjithë përfaqësuesit e SCP-ve pjesëmarrës në debate.

Disa OSHMA kanë transmetuar gjatë fushatës edhe debate me ekspertë/analistë të pavarur, në të cilat janë analizuar paraqitjet, programet dhe aktivitetet e fushatës së kandidatëve të ndryshëm. Në rast të mos shfrytëzimit të termineve të ofruara nga mediat për SCP-të, OSHMA-të kanë njoftuar shikuesit për mos shfrytëzimin e hapësirës së dhënë nga to. Shumica e OSHMA-ve kanë qenë të vëmendshëm që edhe renditja në prezantimin e fushatave të SCP-ve në edicionet e lajmeve të jetë sa më e balancuar dhe me një lloj rotacioni. Ndërsa, raportimi gjatë mbulimit të fushatës ishte kryesisht neutral.

Sa i përket distribuimit të kohës (sasisë së dhënë) në edicionet e lajmeve, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele kanë arritur balancim më të madh kryesisht tek subjektet e certifikuara politike të cilat kanë pasur aktivitete dhe fushatë më të dendur. Megjithatë, TV OPINION dhe TV PRIZREN, sa i përket hapësirës së dhënë në periudhën monitoruese kanë favorizuar SCP-në PDK.

Ndërsa sa i përket OSHMA-ve që transmetojnë në gjuhën serbe, TV MOST dhe TV PULS kanë ofruar hapësirë/ kohë më të madhe për SCP-në SRPSKA LISTA (SL).

Mediet me mbulim lokal mbuluan kryesisht fushatën e SCP-ve të cilat garuan në komunat ku ato operojnë.

OSHMA-të të cilat transmetojnë në gjuhën e minoriteteve kanë transmetuar kryesisht fushatat e SCP-ve nga radhët e minoriteteve.

Prezantimi i kampanjave zgjedhore të SCP-ve nga radhët e minoriteteve në televizionin publik RTK1 dhe RTK2 janë bërë edhe në edicionet e lajmeve në gjuhët e minoriteteve.



Me përjashtim të disa rasteve të përdorimit të shprehjeve denigruese të identifikuara në spotet e SCP SL, gjuha e përdorur në medie gjatë kësaj fushate ka qenë kryesisht në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale.

Edhe në këto zgjedhje, fëmijët ishin pjesë e tubimeve zgjedhore të SCP-ve. Mirëpo, shumë prej ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale janë përkujdesur që fytyrat e këtyre fëmijëve të hijezohen.

Në fillim të fushatës zgjedhore, KPM ka verifikuar nëse në listat e KQZ-së për kryetar të kuvendeve komunale dhe asamblast janë pronarë, apo drejtorë të OSHMA-ve. Për rastet e identifikuara nga KPM janë iniciuar procedurat për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 22.3 të Ligjit për KPM-në.

Në mungesë të kufizimit të hapësirës me pagesë për SCP- të në Ligjin për Zgjedhje, OSHMA-të kanë transmetuar një numër të madh të tubimeve zgjedhore të SCP-ve me pagesë.

## **SHKELJET E IDENTIFIKUARA DHE VEPRIMET E KPM-SË**

Nga monitorimi i fushatës zgjedhore është vërejtur se disa OSHMA kanë vepruar në kundërshtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje. Lidhur me shkeljet e identifikuara, KPM ka ndërmarë masa të parapara në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

Shkeljet e evidentuara kanë të bëjnë me:

- Spotet politike më të gjata se dy minuta;
- Spotet politike të paidentifikuara;
- Prezencën e fëmijëve në spotet politike;
- Dështimin për të ofruar qasje të drejtë dhe të paanshme;
- Shkeljen e heshtjes zgjedhore; dhe
- Mos ofrimine Ditarëve A dhe B.

### **Spotet politike më të gjata se dy minuta (120 s) - shkelje e nenit 49.1 të Ligjit për Zgjedhje**

Neni 49.1 përcakton: *“Pikat reklamuese politike nuk janë më të gjata se dy (2) minuta (120 sekonda)”*.

Spote më të gjata se 120 sekonda janë transmetuar në: TV PRIZREN, TV MOST, TV PULS, RTK1, KTV, TV 21, KLAN KOSOVA, RROKUM TV dhe TV DUKAGJIN. Pas telefonatave dhe Njoftimeve për Shkelje, me përjashtim të RTK1, OSHMA-të kanë ardhur në pajtueshmëri duke transmetuar spote me kohëzgjatje më të shkurtër se 120 sekonda. Rastet e mos pajtueshmërisë janë proceduar sipas procedurave të parapara.

## **Spotet politike të paignifikuara - shkelje e nenit 49.6 të Ligjit për Zgjedhje**

Gjatë monitorimit është vërejtur se disa ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele nuk e kanë bërë identifikimin e duhur të spoteve politike, siç parasheh neni 49 paragrafi 6 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton:

*“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të.”*

Spotet politike të paignifikuara nëse janë me pagesë apo pa pagesë janë transmetuar në: KLAN KOSOVA, TV MOST dhe TV PULS. Pas Njoftimit për Shkelje, OSHMA-të e gjetura në shkelje kanë ardhur në pajtueshmëri.

## **Dështimi për të ofruar qasje të drejtë dhe të paanshme – shkelje e nenit 48 të Ligjit për Zgjedhje**

Në rastet kur OSHMA-të në programet e veta kanë favorizuar gjatë mbulimit kryesisht fushatën e një SCP-je, subjektet transmetuese janë udhëzuar të veprojnë në pajtim me nenin 48 të Ligjit për Zgjedhje, sipas të cilit:

*“Të gjitha mediat sigurojnë se të gjitha subjektet politike të certifikuara përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme në emisionet gjatë fushatës së zgjedhjeve, dhe të gjitha mediat transmetuese u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara qasje të drejtë dhe të paanshme në programet me diskutime politike dhe debate”.*

Kjo shkelje është vërejtur gjatë monitorimit të TV OPINION i cili në fillim të fushatës elektorale i ka dhënë hapësirë vetëm subjektit politik PDK dhe pas komunikimit nga KPM ka filluar të prezentojë edhe fushatat e SCP-ve tjera

## **Shkelje të Kodit të Etikës për Shërbimet Mediale Audio-vizuele**

Gjatë periudhës monitoruese të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2017, është gjetur se gjuha e përdorur në spotin e SL-së, të transmetuar në TV MOST, ishte në kundërshtim me Kodin e Etikës i cili parasheh dispozita ligjore sa i përket përdorimit të gjuhës denigruese në përmbajtjet programore të të licencuarve të KPM-së. Spoti i SL, transmetuar në TV MOST, përmbante sulme ndaj ndershmërisë, integritetit apo cilësive personale si dhe kritikizëm të padrejtë ndaj kandidatëve të SCP-ve tjera si: GI SDP, GI za nas Zvecan dhe PKS. Lidhur me këtë shkelje KPM ka inicuar veprimet e parapara ligjore.

## Prezenca e fëmijëve në spotet politike – shkelje e nenit 9.7 të Kodit të Etikës

Prezenca e fëmijëve në spotet politike të SCP-ve paraqet shkelje të nenit 9 paragrafi 7 të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-vizuele në Republikën e Kosovës, sipas të cilit:

*“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike”.*

Edhe në këto zgjedhje ka pasur prezencë të fëmijëve në spotet politike të SCP-ve. Spotet me prezencë të fëmijëve janë identifikuar në spotin e AAK-së të transmetuar nga OSHMA-të: TV SYRI VIZION, TV DUKAGJINI, KLAN KOSOVA, TV 21 dhe në spotin e SRPSKA LISTA të transmetuar nga TV MOST.

Lidhur me shkeljen e identifikuar, KPM ka dërguar Njoftime për Shkelje të subjektet transmetuese. Në monitorimet e radhës, pas Njoftimit për Shkelje, është gjetur se me përjashtim të TV MOST, televizionet e lartpërmendura kanë ardhur në pajtueshmëri.

## Periudha e heshtjes zgjedhore

Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, më 21 dhe 22 tetor 2017, në kundërshtim me nenin 52.1 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje dhe Udhëzuesin e KPM-së, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele kanë transmetuar:

- Konferencat për media të disa SCP-ve, ku shihen logot dhe simbole tjera të tyre,
- Reagimet e SCP-ve për parregullsitë gjatë procesit të votimit, si dhe
- Deklaratat e kandidatëve të SCP-ve pas votimit të tyre.

Neni 52.1 i Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje përcakton:

*“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon 24 orë para hapjes së vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve”.*

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në materialet që i takojnë aktivitetit të fushatës përfshihen tubimet ose fjalimet politike, mbledhjet, prezantimet publike ose ndonjë aktivitet të përgatitur për të propaganduar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet. Në shkelje të heshtjes zgjedhore janë gjetur: Tribuna CHANNEL, TV KLAN KOSOVA, TV DUKAGJINI dhe TV MOST.

OSHMA- të me mbulim nacional RTK1, KTV dhe TV 21, ishin shumë korrekte gjatë mbulimit të procesit të votimit dhe në përgjithësi të heshtjes zgjedhore.

## Mos ofrimi i Ditarëve – shkelje e nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenit 53:

*“Komisioni i Pavarur për Media siguron se mediat mirëmbajnë një ditar për të regjistruar kohën e emetimit, dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti. Ditari i vlerëson të gjithë treguesit relevant të ekspozimeve, ndaras për secilin subjekt politik, sipas mënyrës së përcaktuar me rregullat e KPM-së”.*

Përmes një shkrese të dërguar para fillimit të fushatës, KPM ka përcjellë te të licencuarit format e Ditarëve me dhe pa pagesë që duhet të mirëmbahen nga mediet, si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre. Nga të licencuarit është kërkuar ta njoftojnë KPM-në nëse do të mbulojnë fushatën zgjedhore, e në rast të mbulimit ka kërkuar që këta Ditarë t'i ofrohen KPM-së pas çdo jave të fushatës zgjedhore.

Para përfundimit të fushatës zgjedhore, OSHMA-të janë përkujtuar edhe një herë për obligimin që e kanë lidhur me ofrimin e Ditarëve në KPM.

Brenda afatit të paraparë në Udhëzuesin e KPM-së, Ditarët me regjistrimet për kohën e ofruar me pagesë apo pa pagesë SCP-ve, i kanë sjellë 25 OSHMA (radio dhe TV). Për rastet e mos dorëzimit të Ditarëve, KPM do të procedojë me veprimet përkatëse ligjore.

### **Përfshirja e udhëheqësve të OSHMA-ve në zgjedhje**

Në Zgjedhjet Lokale 2017 kanë kandiduar për kryetar komune e për asambleist edhe pronarë të OSHMA-ve. Kjo është vërejtur në fillim të fushatës zgjedhore, ku KPM ka verifikuar nëse në listat e KQZ-së për kryetar të kuvendeve komunale dhe asambleist janë edhe pronarë, apo drejtorë të OSHMA-ve.

Nga këto lista është identifikuar se pronarët e TV FESTINA dhe Radio VICTORIA dhe drejtori i Radio VICIANUM ishin kandidatë për kryetarë të komunave apo kandidatë për Zgjedhjet Lokale 2017. Pasi që kjo është në kundërshtim me nenin 22.3 të Ligjit për KPM-në, kandidatët e gjetur në listat e KQZ-së janë këshilluar që menjëherë të fillojnë procedurat e e parapara për të qenë në pajtim me Ligjin e KPM-së.

Radio VICIANUM ka ndërmarrë menjëherë veprimet e nevojshme duke e ndërruar drejtorin e Radio Vicianum dhe rasti është mbyllur, ndërsa për pronarët e Radio VICTORIA dhe TV FESTINA të cilët kanë dështuar të ndërmarrin veprimet e nevojshme, janë iniciuar procedura ligjore.

## VI. ANKESAT E PARASHTRUARA

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore në KPM janë parashtruar katër ankesa ndaj ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele:

1. Ankesa e parë ka të bëjë me mos ftesën e kandidatit për KK të Ferizajt nga Nisma Qytetare për Ferizajn, z. Bashkim FAZLIU, në debat me kandidatët tjerë të kësaj komune më 13 tetor 2017 në TV Klan Kosova.

*Pas kërkesës për sqarim drejtuar KLAN KOSOVA, kandidatit i është ofruar pjesëmarrja në një emision informativ në ditën e nesërme. Pala Ankuese është pajtuar me mundësinë e dhënë rasti është mbyllur.*

2. Për mos ofrim të hapësirës për shpalesje të programit në TV MOST si dhe për përmbajtjen e spotit të SL në kundërshtim me Kodin e Etikës, ankesë ka parashtruar Oliver IVANOVIÇ (GI SDP).

*Lidhur me ankesën, TV MOST-it i është kërkuar që të jap sqarime. TV MOST, përmes postës elektronike, ka ofruar dëshmi se ka njoftuar SCP-të me kohë për terminet dhe çmimet për një sekondë të programit të transmetuar.*

*Deri në fund të fushatës zgjedhore kandidatit të GI SDP, z. Oliver IVANOVIÇ, nuk i është ofruar hapësirë për prezantim të programit të tij politik.*

3. Lidhur me përmbajtjen e spotit politik të SL të transmetuar në TV MOST, ankesë kanë parashtruar edhe kandidatët nga SCP GI za nas Zvecan, z. Dragisa MILOVIÇ, dhe SCP PKS, z. Dragan JABLANOVIÇ.

*Pas Njoftimit për Shkelje, në bazë të monitorimit është vërejtur se TV MOST ka ndërprerë transmetimin e këtij spoti. Ndërsa, ka vazhduar të transmetojë spotin e SL me prezencë të fëmijëve.*

4. Ankesa e katërt ka të bëjë me mos ftesën e z. Xhavit DRENORI (kandidat për kryetar të Drenasit nga SCP VIZIONI PËR DRENASIN) në debatin me kandidatët tjerë në TV KLAN KOSOVA.

*Pas komunikimit me shkrim nga Zyra Ekzekutive (kërkesë për sqarim lidhur me ankesën e parashtruar), KLAN KOSOVA i ka ofruar z. DRENORI hapësirë në programin e mëngjesit, me të cilën nuk është pajtuar Pala Ankuese. Më 19 tetor 2017, KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje Klan Kosovës dhe ka kërkuar që në pajtim me nenin 48 të i Ligjit për Zgjedhje t'i ofrojë z. DRENORI mundësinë për prezantim të programit të tij politik. Deri në fund të fushatës Klan Kosova nuk i ka ofruar hapësirë për prezantim kandidatit për KK të Drenasit.*

## VII. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-të

Të dhënat lidhur me hapësirën e ofruar nga OSHMA-të për Subjektet e Certifikuara Politike nga data 21.09.2017 deri më 20. 10.2017 janë vetëm nga ora 16:00 deri në -24:00.

Për OSHMA-të të cilat nuk kanë ofruar debate dhe intervista gjatë periudhës së fushatës zgjedhore janë paraqitur tabelat vetëm për hapësirën e ofruar në edicionet e lajmeve dhe kronika zgjedhore.

Në edicionet e lajmeve, kronika zgjedhore dhe debatet e transmetuara, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele kanë dedikuar këtë hapësirë për SCP-të:

### *Televizionet me transmetim tokësor me mbulim nacional*

#### RTK1

Edicione të lajmeve/kronika			
	Koha	s	%
S C P	PDK	17325	19.77
	LDK	18792	21.44
	VV	14937	17.04
	AAK	12942	14.77
	AKR	8534	9.74
	NISMA	6623	7.56
	ALTERNATIVA	934	1.07
	BEKIM JASHARI	1416	1.62
	VAKAT	627	0.72
	KDTP	1855	1.96
	PSHDK	66	0.08
	PDASHK	60	0.07
	NDS	656	0.75
	SDA	505	0.58
	PD	217	0.25
	KNRP	105	0.12
	SL	230	0.26
	VISIONI PËR DRENASIN	582	0.66

Debate/intervista			
	Koha	s	%
S C P	PDK	131997	16.01
	LDK	130935	15.88
	VV	121434	14.73
	AAK	110844	13.45
	AKR	71479	8.67
	NISMA	101454	12.31
	ALTERNATIVA	29192	3.54
	BEKIM JASHARI	7088	0.86
	FJALA	32352	3.92
	VAKAT	4575	0.55
	KDTP	5116	0.62
	NISMA QYTETARE PËR FERIZAJ	5366	0.65
	PAI	5366	0.65
	NDS	5116	0.62
	PD	5027	0.61
	BASRI IBRAHIMI	6040	0.73
	FISNIK GJINAJ	6040	0.73
	VISIONI PËR DRENASIN	4195	0.51

	SLS	145	0.17
	FATMIR RASHITI	251	0.29
	NEXHAT KRASNIQI	116	0.13
	INICIATIVA QYTETARE PER DRENASIN	140	0.16
	KTAP	231	0.26
	LB	357	0.41
	<b>Total</b>	<b>87646</b>	<b>100</b>

	SLS	3076	0.37
	FATMIR RASHITI	4230	0.51
	RUFKI SUMA	4892	0.59
	SHAIP SHALA	4209	0.51
	SELAJDIN BYTYÇI	4912	0.6
	NEXHAT KRASNIQI	4912	0.6
	INICIATIVA QYTETARE PËR DRENASIN	4195	0.51
	MEHDI SALI	4320	0.52
	LB	2385	0.29
	INICIATIVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	3629	0.44
	<b>Total</b>	<b>824376</b>	<b>100</b>

## TV 21

Edicione të lajmeve/kronika			
	Koha	s	%
S C P	PDK	3403	17.31
	VV	3910	19.89
	LDK	4346	22.11
	AAK	3990	20.3
	NISMA	1407	7.16
	AKR	1660	8.44
	ALTERNATIV A	224	1.14
	BEKIM JASHARI	160	0.81

Debate/intervista			
	Koha	s	%
S C P	NQF	5400	0.87
	PDK	104538	16.75
	VV	95736	15.34
	LDK	95738	15.34
	AAK	86074	13.79
	NISMA	63184	10.13
	AKR	63186	10.13
	FJALA	21600	3.46

	PEK	196	1
	PAI	364	1.85
	<b>Total</b>	19660	100

	INIVIATIVA QYTETARE PËR DRENASIN	3780	0.61
	VIZIONI PËR DRENASIN	3780	0.61
	ALTERNATIVA	27002	4.33
	PAI	5400	0.87
	INICIATIVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	5400	0.87
	JGP	5400	0.87
	VAKAT	5400	0.87
	PD	5400	0.87
	BEKIM JASHARI	5400	0.87
	BASRI BRAHIMI	5400	0.87
	FISNIK GJINAJ	5400	0.87
	SL	5402	0.87
	NDS	5400	0.87
	<b>Total</b>	624020	100

## KTV

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	VV	4819	18.34
	PDK	5532	21.06
	LDK	5545	21.11
	AAK	4505	17.15
	AKR	1852	7.05
	NISMA	2771	10.55
	ALTERNATIVA	476	1.81
	BEKIM JASHARI	294	1.12
	LB	137	0.52
	PEK	109	0.41
	PD	230	0.88
	<b>Total</b>		26270

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	VV	126584	16.33
	PDK	117233	15.12
	LDK	128932	16.63
	AAK	115133	14.85
	AKR	74033	9.55
	NISMA	85913	11.08
	ALTERNATIVA	37440	4.83
	FJALA	31200	4.02
	PAI	4380	0.57
	PD	4800	0.62
	FATMIR RASHITI	4620	0.6
	VIZIONI PËR DRENAS	6300	0.81



	MEHDI SALI	4620	0.6
	INICIATIVA QYTETARE PËR DRENASIN	6300	0.81
	NEXHAT KRASNIQI	7200	0.93
	NISMA QYTETARE PËR FERIZAJ	4300	0.55
	FISNIK GJINAJ	4800	0.62
	INICIATIVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	4200	0.54
	INICIATIVA SHQIPËTARE PËR KLOKOT	1800	0.23
	SELAJDIN BYTYÇI	5400	0.7
	<b>Total</b>	775188	100

## Televizionet me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Prizrenit

### TV OPINION

Fushata zgjedhore është mbuluar vetëm përmes edicioneve të lajmeve.

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	28726	73.57
	LDK	2718	6.96
	NISMA	2360	6.04
	AKR	382	0.98
	VV	2340	5.99
	AAK	2054	5.26
	FJALA	464	1.19
<b>Total</b>		39044	100

### TV BESA

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	23855	34.54
	LDK	10433	15.1
	NISMA	10690	15.48
	VV	15852	22.95
	AKR	1850	2.68
	AAK	5481	7.94
	NDS	126	0.18
	ALTERNATIVA	682	0.99
	FJALA	102	0.15
<b>Total</b>		69071	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	PDK	23376	20.3
	AAK	23376	20.3
	LDK	23376	20.3
	VV	19239	16.71
	NISMA	20886	18.14
	AKR	2450	2.13
	FJALA	2450	2.13
	<b>Total</b>		115153

## TV PRIZRENI

Fushata zgjedhore është mbuluar vetëm përmes edicioneve të lajmeve.

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	18307	40.87
	LDK	10511	23.47
	VV	6836	15.26
	AAK	605	1.35
	NISMA	7856	17.54
	FJALA	352	0.79
	ALTERNATIVA	322	0.72
<b>Total</b>		44789	100

## TV BALLKAN

Nuk ka mbuluar fushatën zgjedhore të SÇP përmes lajmeve apo kronikave zgjedhore.

*Televizionet me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Mitrovicës*

**TV MOST**

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	SL	12759	98.56
	GI SDP	125	0.97
	GI ZA NAS ZVECAN	62	0.48
	<b>Total</b>	12946	100

**TV MITROVICA**

Fushata zgjedhore është mbuluar vetëm përmes debateve/intervistave.

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	PDK	11803	12.68
	LDK	11803	12.68
	VV	11803	12.68
	AAK	11803	12.68
	AKR	13587	14.6
	NISMA	11803	12.68
	SALIH MEHA	776	0.83
	FJALA	4918	5.29
	FISNIK GJINAJ	4918	5.29
	ALTERNATIVA	4918	5.29
	BASRI BRAHIMI	4918	5.29
	<b>Total</b>	93050	100

**TV MIR**

Ka mbuluar fushatën zgjedhore vetëm përmes dy intervistave pa pagesë. Pjesa tjetër është mbuluar me programe me pagesë.

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	PKS	2580	68.25
	GI SDP	1200	31.75
<b>Total</b>		3780	100

*Televizionet me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regionin e Gjilanit*

**TV LIRIA**

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	VV	6615	27.25
	PDK	5359	22.08
	LDK	8939	36.83
	AAK	860	3.54
	AKR	510	2.1
	NISMA	1326	5.46
	PAI	664	2.74
	<b>Total</b>	24273	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	VV	1800	18.99
	PDK	1620	17.09
	AAK	1500	15.82
	AKR	960	10.13
	NISMA	1800	18.99
	PAI	1800	18.99
	<b>Total</b>	9480	100

**TV ILIRIA**

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	2294	23.41
	LDK	726	7.41
	AAK	1280	13.06
	VV	1896	19.34
	AKR	2165	22.09
	NISMA	952	9.71
	BEKIM JASHARI	488	4.98
	<b>Total</b>	9801	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
SCP	AAK	4800	100
<b>Total</b>		4800	100

**TV TEMA**

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	2360	14.72
	VV	6040	17.01
	LDK	1626	4.58
	AAK	1032	2.91
	NISMA	1332	3.75
	AKR	2135	6.01

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	PDK	8420	19.2
	VV	3600	8.21
	LDK	5400	12.32
	AAK	5400	12.32
	NISMA	7583	17.3
	AKR	2640	6.02

	NQF	502	1.41
	PAI	1005	2.83
<b>Total</b>		16032	100

	NQF	5400	12.32
	PAI	5400	12.32
<b>Total</b>		43843	100

## TV VALI

Fushata zgjedhore është mbuluar vetëm përmes edicioneve të lajmeve/kronika zgjedhore.

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	2684	19.59
	VV	5110	37.29
	LDK	428	3.12
	AAK	1032	7.53
	NISMA	1674	12.22
	AKR	1951	14.24
	PAI	823	6.01
<b>Total</b>		13702	100

## TV PULS

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	SL	7558	72.75
	SLS	1709	16.45
	GI CENTRALNO KOSOVO	54	0.52
	GI NARODNA PRAVDA	46	0.44
	PDS	400	3.85
	GI SDP	264	2.54
	NSK	50	0.48
	GI ZA NAS ZVECAN	86	0.83
	PKS	56	0.54
	LDK	166	1.6
	<b>Total</b>		10389

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	GI SDP	650	100
	<b>Total</b>	650	100

**TV FESTINA** dhe **TV HERC** që operojnë në këtë regjion, nuk kanë përcjellë fushatën zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale 2017.

*Televizionet me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regionin e Pejës*

**TV SYRI VIZION**

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	21584	16.84
	LDK	7626	5.95
	VV	17491	13.65
	AAK	21591	16.84
	AKR	10654	8.31
	NISMA	16773	13.09
	ALTERNATIVA	29949	23.37
	PSHDK	1162	0.91
	PD	772	0.6
	PLE	576	0.45
	<b>Total</b>	<b>128178</b>	<b>100</b>

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	PDK	35820	14.41
	LDK	38320	15.42
	VV	32183	12.95
	AAK	27202	10.95
	AKR	30617	12.32
	NISMA	41020	16.51
	ALTERNATIVA	41020	16.51
	PLE	2318	0.93
	<b>Total</b>	<b>248500</b>	<b>100</b>

**TV DUKAGJINI**

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	4879	22.03
	LDK	5731	25.87
	VV	3415	15.42
	AAK	3413	15.41
	AKR	3008	13.58
	NISMA	1322	5.97
	ALTERNATIVA	161	0.73
	INICIATIAVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	168	0.76
	BEKIM JASHARI	52	0.23
	<b>Total</b>	<b>22149</b>	<b>100</b>

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	PDK	103903	14.72
	LDK	115335	16.34
	VV	123479	17.5
	AAK	116244	16.47
	AKR	61482	8.71
	NISMA	94947	13.45
	ALTERNATIVA	27167	3.85
	NISMA QYTETARE PËR FERIZAJ	7800	1.11
	PARTIA FJALA	17480	2.48
	YLBER ISLAMI	158	0.02
	FATMIR RASHITI	5560	0.79
	MEHDI SALIHU	5560	0.79
	VIZIONI PËR DRENASIN	8035	1.14

	INICIATIVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	5749	0.81
	PD	5749	0.81
	FISNIK GJINAJ	957	0.14
	NEXHAT KRASNIQI	6060	0.86
	<b>Total</b>	<b>705665</b>	<b>100</b>

*Televizionet me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes*

**RTK 2**

<b>Edicione të lajmeve/kronika</b>			
	<b>Koha</b>	<b>s</b>	<b>%</b>
<b>S C P</b>	SLS	1170	22.67
	GI CENTRALNO KOSOVO	278	5.39
	GI NOVI POCETAK	150	2.91
	PDS	235	4.55
	SL	1305	25.28
	GI SDP	493	9.55
	NDS	423	8.19
	VAKAT	448	8.68
	SDA	396	7.67
	GI ZA NAS ZVECAN	72	1.39
	PKS	192	3.72
	<b>Total</b>	<b>5162</b>	<b>100</b>

<b>Debate/intervista</b>			
	<b>Koha</b>	<b>s</b>	<b>%</b>
<b>S C P</b>	SLS	4043	11.07
	GI CENTRALNO KOSOVO	4043	11.07
	GI NOVI POCETAK	4999	13.68
	PDS	4744	12.98
	SL	5084	13.92
	INICIATIVA SHQIPËTARE PËR KLLOKOT	752	2.06
	INICIATIVA QYTETARE SHQIPTARE	4043	11.07
	VV	4043	11.07
	GI NARODNA SLOGA	611	1.67
	JGP	1021	2.79
	AKR	1030	2.82
	GI SDP	1051	2.88
	NISMA	1072	2.93
	<b>Total</b>	<b>36536</b>	<b>100</b>



## RROKUM TV

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	PDK	8126	39.7
	VV	2522	12.3
	LDK	3802	18.6
	AAK	2233	10.9
	NISMA	1028	5
	AKR	2193	10.7
	ALTERNATIVA	164	0.8
	BEKIM JASHARI	372	1.8
	INICIATIVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	42	0.2
	<b>Total</b>	20482	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	ALTERNATIVA	13846	7.48
	PDK	17184	9.28
	VV	33948	18.34
	LDK	45146	24.39
	AAK	44765	24.19
	NISMA	3662	1.98
	AKR	23069	12.46
	FJALA	3462	1.87
	<b>Total</b>	185082	100

## TV KIM

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	SLS	1846	23.47
	GI SDP	1609	20.45
	PKS	277	3.52
	SL	2592	32.95
	GI ZA NAS ZVECAN	375	4.77
	GI CENTRALNO KOSOVO	245	3.11
	GI NARODNA PRAVDA	100	1.27
	PDS	432	5.49
	GI NOVI POCETAK	142	1.81
	NSK	86	1.09
	IQSH	130	1.65
	AAK	33	0.42
	<b>Total</b>	7867	100

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	SLS	1752	11.96
	GI SDP	1786	12.19
	GI CENTRALNO KOSOVO	2735	18.67
	GI NOVI POCETAK	2776	18.95
	SL	2758	18.83
	PDS	1932	13.19
	IQSH	910	6.21
	<b>Total</b>	14649	100

## TRIBUNA CHANNEL

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	AAK	1518	9.21
	LDK	4589	27.84
	PDK	3686	22.36
	VV	1475	8.95
	NISMA	1496	9.08
	AKR	2628	15.94
	BEKIM JASHARI	716	4.34
	FATMIR RASHITI	105	0.64
	INICIATIVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	115	0.7
	GI SDP	54	0.33
	PSHDK	102	0.62
	<b>Total</b>	<b>16484</b>	<b>100</b>

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	AAK	138267	14.44
	LDK	149198	15.58
	PDK	153256	16
	VV	152980	15.98
	NISMA	118607	12.39
	AKR	82288	8.59
	ALTERNATIVA	35646	3.72
	PD	5548	0.58
	FJALA	40505	4.23
	SELAJDIN BYTYÇI	7859	0.82
	NEXHAT KRASNIQI	7868	0.82
	KDTP	6840	0.71
	NDS	6840	0.71
	VIZIONI PËR DRENASIN	7620	0.8
	INICIATIVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	5880	0.61
	MEHDI SALI	6300	0.66
	FATMIR RASHITI	6300	0.66
	YLBER ISLAMI	4864	0.51
	REFKI SUMA	4590	0.48
	BASRI BRAHIMI	8180	0.85
FISNIK GJINAJ	8180	0.85	
<b>Total</b>	<b>957616</b>	<b>100</b>	

## KLAN KOSOVA

Edicione të lajmeve/kronika			
Koha		s	%
S C P	AAK	4950	21.6
	LDK	6368	27.79
	PDK	4042	17.64

Debate/intervista			
Koha		s	%
S C P	AAK	106432	17.4
	LDK	116229	19
	PDK	102932	16.83

VV	4020	17.54
NISMA	1446	6.31
AKR	1677	7.32
REFKI SUMA	76	0.33
PAI	163	0.71
SL	138	0.6
GI SDP	34	0.15
<b>Total</b>	22914	100

VV	106473	17.41
NISMA	87707	14.34
AKR	62950	10.29
ALTERNATI VA	17779	2.91
INICIATIVA TË PAVARURIT E ISTOGUT	6087	1
PD	5073	0.83
<b>Total</b>	611662	100

## VIII. SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË GJATË MONITORIMIT TË PAJTUESHMËRISË SË TË LICENCUARVE TË KPM-SË

KPM ka të licencuar: 83 radio, 20 televizione si dhe 51 OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes. Për shkak të vëllimit të madh të punëve dhe numrit të vogël të stafit monitorues, KPM ka monitoruar 25 TV nacionale, regjionale/lokale si dhe OSHMA-të me program gjeneralistik, të cilët operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes. Lidhur me vlerësimin e pajtueshmërisë për radio-stacionet, KPM ka vendosur që të monitorohen në bazë të ankesave të parashtruara nga palët.

Buxheti i pamjaftueshëm për përmbushjen e obligimit për vlerësimin e pajtueshmërisë së OSHMA-ve me Ligjin për Zgjedhje ishte sfida e radhës për KPM-në. Edhe përkundër kërkesës së përsëritur të KPM-së për buxhet shtesë për monitorimin e fushatës për zgjedhjet lokale, të cilën KPM e ka bërë qysh para zgjedhjeve nacionale, MF nuk ka ndarë mjete buxhetore për të lehtësuar përmbushjen e obligimit ligjor (monitorimin e medieve gjatë fushatës zgjedhore). Në këtë mënyrë, KPM ka angazhuar tërë stafin për t'u përfshirë në këtë aktivitet. Në mungesë të buxhetit dhe pamundësisë për të angazhuar staf shtesë, monitorimi i një numri të konsiderueshëm prej 25 OSHMA-ve është udhëhequr vetëm nga 10 zyrtarë të Departamentit të Monitorimit dhe Analizës. Kjo përbënte ngarkesë të madhe për DMA-në pasi që krahas angazhimeve tjera për vlerësimin e pajtueshmërisë së Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuele me Ligjin, rregulloret e KPM-së si dhe obligimet që dalin nga trajtimi i rasteve ditore ex-officio dhe ankesave, është bërë edhe monitorimi i performancës së medieve gjatë mbulimit të fushatës 30 ditore për zgjedhjet lokale.

Përkundër përvojës disa vjeçare në mbulimin e fushatave zgjedhore të shumicës së medieve të licencuara, dërgimit të Udhëzuesit për Zgjedhje të KPM-së bashkë me shkresa dhe sqarime shtesë si dhe organizimit të takimeve me OSHMA-të, KPM vëren shkelje të përsëritura të Ligjit për Zgjedhje. Me qëllim të ardhjes në pajtueshmëri të të licencuarve të KPM-së me Ligjin për Zgjedhje, KPM i konsideron të domosdoshme takimet me OSHMA-të si dhe komunikimet e vazhdueshme me to veçmas në kohë fushatash zgjedhore.

Përvojat e këtilla dëshmojnë se një komunikim i vazhdueshëm në mes të KPM dhe Ofruesve të Shërbimeve Programore me sqarime të njëjta është i domosdoshëm në çdo vit zgjedhorë.

Për të mundur kryerjen e suksesshme të aktiviteteve të këtilla, KPM e konsideron të domosdoshme sigurimin e resurseve të nevojshme, buxhet shtesë në çdo vit zgjedhor i cili do t'i mundësojë:

1. angazhimin e stafit shtesë dhe përgatitjen/trajnimin e tyre për monitorimin e OSHMA-ve gjatë fushatave zgjedhore;
2. realizimin e aktiviteteve përgatitore para fillimit të fushatave zgjedhore;
3. organizimin e takimeve dhe debateve me përfaqësues të OSHMA-ve dhe palëve tjera të interesit, me qëllim të qartësimit të të gjitha dilemave që lidhen me mbulimin e fushatës zgjedhore (përfshirë këtu edhe ndarjen e rolit të KPM-së nga institucionet tjera përgjegjëse për procesin zgjedhor;
4. Realizimin e monitorimit.

## IX. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në bazë të të dhënave të gjetura nga monitorimi i periudhës zgjedhore, KPM **konkludon**:

OSHMA-të kanë raportuar kryesisht në mënyrë korrekte, në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje si dhe Kodin e Etikës për OSHMA-të. Transmetimi i fushatave në lajme, kronika, debate, intervista dhe spote të SÇP, dëshmon për diversitetin e programeve, mundësinë e ofruar për shpalosjen e platformave politike të SÇP-ve si dhe pasqyrimin e atmosferës elektorale në përgjithësi.

1. *Televizioni Publik i Kosovës RTK1, si dhe dy televizionet nacionale me mbulim tokësorë KTV dhe TV 21, kanë arritur balancim më të madh sa i përket hapësirës së ofruar, kryesisht të SÇP-të të cilat kanë pasur aktivitet dhe fushatë më të dendur politike.*
2. *TV OPINION, TV PRIZRENI dhe TRIBUNA CHANNEL gjatë raportimit kanë ofruar hapësirë më të madhe për subjektin PDK krahasuar me subjektet tjera.*
3. *TV MOST dhe TV PULS, kanë ofruar hapësirë më të madhe për subjektin SL.*
4. Në ditën e votimit, disa nga OSHMA-të kanë mbuluar aktivitete të cilat kanë rënë ndesh me heshtjen zgjedhore.
5. Pronarë dhe drejtues të mediave janë përfshirë në zgjedhje duke kandiduar për Kryetar dhe Kuvend të Komunës.

Në bazë të të gjeturave nga monitorimi i periudhës zgjedhore, të prezantuara më lartë, KPM **rekomandon**:

1. Spotet politike qartësisht të identifikohen nëse janë me apo pa pagese si dhe të tregohet individ/subjekti përgjegjës për të, sipas nenit 49.6 të Ligjit për Zgjedhje.
2. Të licencuarit duhet të shmangin transmetimin e spoteve politike me prezencë të fëmijëve. Kjo me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve në përmbajtjet programore dhe shmangies nga keqpërdorimet e tyre për qëllime/efekte politike.
3. Të licencuarit duhet të jenë më të vëmendshëm gjatë mbulimit të periudhës së heshtjes zgjedhore, veçmas gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta, ku ekziston mundësia e keqpërdorimit të hapësirës së ofruar qoftë nga kandidatët apo edhe qytetar të intervistuar, për të bërë thirrje apo promovim për ndonjë SÇP të caktuar, gjë që mund të ndikojnë në procesin zgjedhor.
4. Të licencuarit duhet të evitojnë transmetimin e reagimeve apo konferencave për media të SCP-ve, të cilat në shumicën e rasteve organizohen për qëllime të tyre, më shumë të natyrës propaganduese, në prapavijë të të cilave zakonisht vërehen logo/simbole dhe flamuj partiak, moto të fushatës së tyre, numrit garues apo ndonjë detaj tjetër.

Në periudhën e heshtjes zgjedhore, institucioni i vetëm zyrtar për informim lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, parregullsitë dhe keqpërdorimet e mundshme në vendvotimeve është Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ).

5. Të licencuarit duhet të ofrojnë në KPM ditaret për kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti.
6. Gjuha e përdorur gjatë fushatave zgjedhore duhet në jetë në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale, duke respektuar parimet etike, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut. Gjithashtu, nuk duhet të përmbaj gjuhë të dëmshme, fyese, denigruese dhe gjuhë të urrejtjes apo materiale që mund të nxisin dhunë, diskriminojnë apo njollosin individ apo grupe të caktuar të shoqërisë.
7. Pronarët dhe drejtuesit e mediave duhet që sapo të vendosin të kandidojnë në zgjedhje dhe të jenë anëtarë të organeve ekzekutive të partive politike, të njoftojnë KPM-në dhe të ndërmarrin veprimet e duhura për të hequr dorë nga pozita në medium. Kjo me qëllim të shmangies së ndikimit të tyre përmes mediave që ata udhëheqin.

#

## **KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**

**1 nëntor 2017**